



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2003/7 prot.

Datë 15/08/2024

V E N D I M

Nr. 1066/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15/08/2024, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “DELTA PHARMA - AL” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-03249-05-02-2024, me objekt: “B1 - Blerje barna sistemet Anestezie reanimacion, Anti tuberkulare, Antineoplastike dhe imunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna dermatologjike, Barna hormonale sistemike, Lëndë kontrasti për CT, Lëndë kontrasti për MRI, Lëndë kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës, Organet e shqisave, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular”, ndarë në 115 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj”, me fond limit 3,660,634,272 (tre miliard e gjashtëqind e gjashtëdhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH ose 36,493,214 Euro pa TVSH konvertuar ne euro sipas kursit zyrtar te Bankes se Shqiperise date 02/05/2024, Loti 55 me Nr.REF-03376-05-02-2024, me objekt: “Lot55 Iodine x 370mg/ml” me fond limit 99,905,396.00 (nëntëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e pesë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH ose 995,966 (nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH konvertuar ne euro sipas kursit zyrtar te Bankes se Shqiperise date 02/05/2024, zhvilluar në datën 03.06.2024 nga

autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ankimues: Operatori ekonomik “DELTA PHARMA - AL” SHPK me Nipt K62202046U dhe me adresë: *Autostrada Tiranë - Durrës, km.3, zona kadastrale 2679, nr.pasurie 19/27/1 Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Adresa: Rruga e Kavajës, Nr 1001, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V e r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.05.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-03249-05-02-2024, me objekt: “BI - Blerje barna sistemet Anestezë reanimacion, Anti tuberkulare, Antineoplastike dhe imunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna dermatologjike, Barna hormonale sistemike, Lëndë kontrasti për CT, Lëndë kontrasti për MRI, Lëndë kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës, Organet e shqisave, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular”, ndarë në 115 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj”, me fond limit 3,660,634,272 (tre miliard e gjashtëqind e gjashtëdhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH ose 36,493,214 Euro pa TVSH konvertuar ne euro sipas kursit zyrtar te Bankes se Shqiperise date 02/05/2024, Loti 55 me Nr.REF-03376-05-02-2024, me objekt: “Lot55 Iodine x 370mg/ml” me fond limit 99,905,396.00 (nëntëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e pesë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH ose 995,966 (nëntëqind enëntëdhjetë e pesë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH konvertuar ne euro sipas kursit zyrtar te Bankes se Shqiperise date 02/05/2024, zhvilluar në datën 03.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

II.2. Në datë 03.06.2024 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 02.07.2024 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

- | | | |
|-----------------------------|---------------------|-------------|
| 1. “DELTA PHARMA - AL” SHPK | 69,477,760.00 leke | kualifikuar |
| 2. “EDNA - FARMA” SHPK | 98,560,000.00 leke | kualifikuar |
| 3. “INCOMED” shpk | pa ofertë ekonomike | |

II.4 Në datën 05.07.2024 autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës dhe ka njoftuar elektronikisht operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

- | | | |
|-----------------------------|---------------------|--------------|
| 1. “DELTA PHARMA - AL” SHPK | 69,477,760.00 leke | skualifikuar |
| 2. “EDNA - FARMA” SHPK | 98,560,000.00 leke | kualifikuar |
| 3. “INCOMED” shpk | pa ofertë ekonomike | |

Operatori ekonomik “Delta Pharma -Al” SHPK rezulton i skualifikuar në këtë procedurë prokurimi me arsyetimin si më poshtë vijon:

“Më datë 02.07.2024 KVO nëpërmjet SPE njofton operatorin ekonomik DELTA PHARMA – AL për dorëzim dokumentacioni për këtë lot. Ky operator më datë 04.07.2024 dorëzohet

dokumentacioni pranë KVO në MSHMS. Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua si më poshtë vijon:

OE për plotësimin e kriterëve të vecanta ka paraqitur dokumentacion për Lot56 Iodine x 370mg/ml 100 ml Flakon dhe jo për Lot55 Iodine x 370mg/ml 200 ml Flakon.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit për plotësimin e kriterëve të përgjithshme është dorëzuar edhe shkresa nga OSHEE për vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike. Vërtetimi është PA PËRFSHIRË muajin prill 2024. Procedura është hapur për vlerësim më datë 03.06.2024. Njoftimi për dorëzim dokumentacioni për Lot55 është bërë më datë 02.07.2024 dhe dorëzimi i dokumentacionit është bërë më datë 04.07.2024. Pra operatori ekonomik ka pasur tërë kohën e nevojshme për të dorëzuar vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve të energjisë elektrike për muajin prill 2024.

Operatori ekonomik në shtojcë 8 të vetë deklaramit ka deklaruar që i ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike ku deklaroi se dokumenti që vërteton këtë është “Lloji i dokumentit që e vërteton sa më lart, [Vërteim debie] lëshuar nga autoriteti: FURNIZUESI I SHERBIMIT UNIVERSAL (FSHU)].

Kjo deklaratë nuk është e saktë pasi nuk ka një dokument që të vërtetojë pagesën e faturave të maturuara të energjisë elektrike.

Në vendimin Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 40, Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave pika 7 përcakton:

7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në bazë të vendimit 109 datë 21.10.2011 “Për Miratimin e Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike të Klientëve Jo-Familjarë”, Neni 9, Pagesa dhe afati për kryerjen e saj

9.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv) si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, **jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.**

Në shtojcën 1 të DST pika a, operatori ekonomik ka konfirmuar se ka konsultuar dhe nuk ka asnjë rezervë për dokumentat e tenderit të procedurës me objekt...

Kështu që është detyrë e operatorit ekonomik që të paraqesë dokumentacionin sipas kërkesave të DT.

Nga sa më lart KVO vlerëson se për plotësimin e kushteve të vecanta për Lot55 Iodine x 370mg/ml 200 ml Flakon operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion dhe në dokumentacionin për plotësimin e kritereve të përgjithshme, vërtetimi i debisë për OSHEE nuk është sipas kërkesave të DT dhe sipas përcaktimeve ligjore.

Nga sa më sipër ky operator skualifikohet”.

II.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 12.07.2024 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke shpallur fitues shoqërinë *“EDNA - FARMA” SHPK*.

II.6. Në datën 19.07.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4343 datë 19.07.2024, dhe me nr. 2003/2024 prot, datë 19.07.2024, e operatorit ekonomik *“DELTA PHARMA - AL” SHPK*, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2003/2, datë 22.07.2024, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues *“DELTA PHARMA - AL” SHPK*, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Me shkresën nr. 1989/40 prot, datë 26.07.2024 protokolluar me tonën me nr. 2003/3 prot, datë 29.07.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues *“DELTA PHARMA - AL” SHPK*, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.9. Me shkresën nr. 2002/5 prot., datë 09.08.2024 me objekt *“Kërkesë për informacion”*, Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur ka kërkuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A (FSHU) informacionin si më poshtë:

- 1. A janë maturuar në datën 03.06.2024, detyrimet e energjisë elektrike të muajit prill 2024 për subjektin “DELTA PHARMA-AL” SHPK me NIPT: K62202046U, për kontratën (me kod) TR3V160233579353 titullar i të cilës është po subjekti “DELTA PHARMA-AL” SHPK?*

II.10. Me shkresën nr. 3050/1 prot, datë 13.08.2024, protokolluar me tonën me nr. 2002/6 prot, datë 13.08.2024, është depozituar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A (FSHU) në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni si më poshtë:

“Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 2002/5 Prot., datë 09.08.2024, regjistruar tek Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA. me Nr. 5322 Prot, datë 12.08.2024, kaluar me shkresë përcjellëse pranë Furnizuesit të Tregut të Lirë SHA.me Nr. 3050 Prot datë 12.08.2024, ku keni kërkuar informacioni mbi maturimin me datë 03.06.2024 të detyrimeve të energjisë elektrike për muajin prill 2024 për subjektin "DELTA PHARMA-AL" për kontratën me kod klienti TR3V160233579353, ju informojmë si më poshtë vijon:

Sipas të dhënave të sistemit tonë të faturimit subjekti "DELTA PHARMA-AL" SHPK me NUIS K62202046U dhe me përfaqësues ligjor z. Eduart Curraj është titullar i kontratës së furnizimit me shoqërinë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" SH.A./OSHEE Group SH.A. nga data 1 janar 2024.

Pagesa e faturës së shitjes së energjisë elektrike e muajit Prill 2024 është kryer nga ana e subjektit më datë 31.05.2024.”.

II.11. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Delta Pharma – AL” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: “...dokumentacioni fizik i paraqitur nga ana jonë për Lot 55 është paraqitur i plotë por ka vetëm një ngatarrësë të tre dokumentave: formulari i ofertës, lista e cmimit, formulari i sigurimit të ofertës, të cilat si rezultat i një lapsusi gabimi njerëzor janë ngatërruar dhe gabimisht janë dorëzuar ato të Lot 56. Loti 55 është product “Iodine x 370 mg/ml formedoza 200 mg” ndërsa loti 56 është product “iodine x 370 mg/ml formedoza 100 mg”, pra kanë ndryshim nga njëra tjetra vetëm formedozën”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Në shtojcën 7 “FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT ”, të dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Shënim për operatorët ekonomik:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e

kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”

III.1.2 Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprimet me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht : “1. *Bashkë me dorëzimin e*

kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.3. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.
3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.
4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.
5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.
6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.
- Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.
7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion

barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.1.5. Referuar pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të dorëzojë pranë autoriteteve kontraktore dokumentet provuese të përmbushura me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Nisur nga arsyeja e skualifikimit të cituar në raport audit nga komisioni i vlerësimit të ofertave me arsyetimin se “*Më datë 02.07.2024 KVO nëpërmjet SPE njofton operatorin ekonomik DELTA PHARMA – AL për dorëzim dokumentacioni për këtë lot. Ky operator më datë 04.07.2024 dorëzohet dokumentacioni pranë KVO në MSHMS. Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua si më poshtë vijon: OE për plotësimin e kriterëve të vecanta ka paraqitur dokumentacion për Lot56 Iodine x 370mg/ml 100 ml Flakon dhe jo për Lot55 Iodine x 370mg/ml 200 ml Flakon*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se është një arsye evazive, e paqartë, duke mos përcaktuar konkretisht dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik për lotin 56 me objekt “*Iodine x 370mg/ml 100 ml Flakon*” duke i hequr në këtë mënyrë edhe operatorit ekonomik mundësinë e paraqitjes së pretendimeve të tij nëpërmjet ankesës.

Komisioni gjykon, se ashtu sikurse është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, të vërtetojë se disponon kapacitetet tekniko-ligjore në lidhje me përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, edhe autoriteti kontraktor (komisioni vlerësimit të ofertave) ka barrën e provës të vërtetojë dhe argumentojë se cili nga kriteret nuk përmbushet nga operatori ekonomik . Pra bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës në rastin konkret për vërtetueshmërinë e pretendimit i takonte komisionit të vlerësimit të ofertave të identifikonte në mënyrë të saktë dhe të qartë, se cili prej kriterëve të veçanta të kualifikimit apo specifikimet teknike nuk përmbushet, apo cilat prej dokumenteve të dorëzuara konkretisht janë dokumente për lot 56 “*Iodine x 370 mg/ml 100 ml flakon*” dhe cilat për lot 55 “*iodine x 370mg/ml 200 ml flakon*”, pra në rastin konkret komisioni i vlerësimit të ofertave ka dështuar ta vërtetojë atë. Është detyrë e zyrtarëve përgjegjës, anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të pasqyrojnë në SPE vlerësimin e tyre në mënyrë të

qartë, konkret dhe të kuptueshëm, në përputhje me LPP. Komisioni i Prokurimit Publik, i është referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtësisë, e cila në çështje të ngjashme (shiko Çështjen C-27/15 Pippo Pizzo) ka konkluduar, se shkaqet e skualifikimit duhet të përcaktohen qartësisht dhe të publikohen paraprakisht në kohë të mjaftueshme, me qëllim që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të njihen me këto shkaqe. GJED në vendimin e mësipërm ka konfirmuar se “përcaktim qartësisht” i shkaqeve të skualifikimit, do të thotë që të garantohet se ofertuesit janë njohur me kërkesat specifike procedurale dhe që të njëjtat kërkesa, aplikohen njëjloj për të gjithë ofertuesit. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se shkeljet e mësipërme, cenojnë në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenojnë edhe parimin e sigurisë juridike. Në jurisprudencën e saj Inter Allia, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se “Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin”. Sa më sipër, K.P.P. gjykon, se në rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi.

Akoma më tej referuar pretendimeve të ngritura nga operatori ekonomik “Delta Pharma- AL” SHPK me arsyetimin se “dokumentacioni fizik i paraqitur nga ana jonë për Lot 55 është paraqitur i plotë por ka vetëm një ngatarrësë të tre dokumentave: formulari i ofertës, lista e cmimit, formulari i sigurimit të ofertës, të cilat si rezultat i një lapsusi gabimi njërëzor janë ngatërruar dhe gabimisht janë dorëzuar ato të Lot 56. Loti 55 është produkt “Iodine x 370 mg/ml formedozë 200 mg” ndërsa loti 56 është produkt “iodine x 370 mg/ml formedozë 100 mg”, pra kanë ndryshim nga njëra tjetra vetëm formedozën”, Komisioni gjykon se referuar pikës 3 të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimi publik”, ku përcaktohet se “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”, gjithashtu referuar nenit 82 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke

kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;
- ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe
- iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në këto kushte autoriteti kontraktor në momentin që konstaton se dokumentet e dorëzuara fizikisht nuk përputheshin me dokumentet e ngarkuara në SPE nga operatoriekonomik në momentin në momentin e ofertimit duhet ti kërkonte sqarime operatorit ekonomik “Delta-Pharma” SHPK lidhur me dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në datë 04.07.2024.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor të rivlerësojë dhe të sqarojë operatorin ekonomik lidhur me dokumentet e dorëzuara në përmbushje të nenit 26 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke përcaktuar konkretisht dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik për lotin 56 me objekt “Iodine x 370mg/ml 100 ml Flakon”.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Delta Pharma – AL” SHPK qëndron pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatori ekonomik “DELTA PHARMA - AL” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: “Nga shqyrtimi i dokumentacionit për plotësimin e kriterëve të përgjithshme është dorëzuar edhe shkresa nga OSHEE për vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike. Vërtetimi është PA PËRFSHIRË muajin prill 2024. Procedura është hapur për vlerësim më datë 03.06.2024. Njoftimi për dorëzim dokumentacioni për Lot55 është bërë më datë 02.07.2024 dhe dorëzimi i dokumentacionit është bërë më datë 04.07.2024. Pra operatori ekonomik ka pasur tërë kohën e nevojshme për të dorëzuar vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve të energjisë elektrike për muajin prill 2024. Operatori ekonomik në shtojcë 8 të vetë deklarimit ka deklaruar që i ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike ku deklaroi se dokumenti që vërteton këtë është “Lloji i dokumentit që e vërteton sa më lart, [Vërteim debie] lëshuar nga autoriteti: FURNIZUESI I SHERBIMIT UNIVERSAL (FSHU)].Kjo deklaratë nuk është e saktë pasi nuk ka një dokument që të vërtetojë pagesën e faturave të maturuara të energjisë elektrike.Në vendimin Nr. 285,

datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 40, Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave pika 7 përcakton:

7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në bazë të vendimit 109 datë 21.10.2011 “Për Miratimin e Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike të Klientëve Jo-Familjarë”, Neni 9, Pagesa dhe afati për kryerjen e saj

9.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv) si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, **jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.**

Në shtojcën 1 të DST pika a, operatori ekonomik ka konfirmuar se ka konsultuar dhe nuk ka asnjë rezervë për dokumentat e tenderit të procedurës me objekt...

Kështu që është detyrë e operatorit ekonomik që të paraqesë dokumentacionin sipas kërkesave të DT. Nga sa më lart KVO vlerëson se për plotësimin e kushteve të veçanta për Lot55 Iodine x 370mg/ml 200 ml Flakon operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion dhe në dokumentacionin për plotësimin e kriterëve të përgjithshme, vërtetimi i debisë për OSHEE nuk është sipas kërkesave të DT dhe sipas përcaktimeve ligjore. Nga sa më sipër ky operator skualifikohet.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “Formulari i Krieteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 1/e “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret kualifikuese, si më poshtë vijon:

“I. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.”.

III.2.2. Në shtojcën 7 “Formulari i Krieteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 1/a “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT - të njëjta për të gjitha lotet” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë vijon:

“I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.”

III.2.3. Në dokumentat e tenderti të publikuara në Sistemin Elektronik të Prokurimit (SPE) nga ana e autoritetit kontraktor, pjesë përbërëse është edhe Shtojcën nr. 8 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*”, si më poshtë vijon:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)
FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. *Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;*
2. *Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;*
3. *Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;*
4. *Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;*
5. *Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:*
 - a) *paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;*
 - b) *është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.*
6. *Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):*
 - a) *Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;*
 - b) *Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).*
7. *Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:*
 - a) *çmimet ;*
 - b) *metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;*
 - c) *qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,*
 - d) *paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.*
8. *Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).*
9. *Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes*

zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik

janë:

- *Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.*

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

*Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.***

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nejjshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme_____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Profili i punonjësve <hr/> <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.2.4. Për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në pikën 1/e “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT” të Shtojcën 7 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT - të njëjta për të gjitha lotet”, operatori ekonomik ofertues “DELTA PHARMA - AL” SHPK ka dorëzuar në dokumentacionin e ofertës Shtojcën 8 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” ku në seksionin A: “DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT” ka deklaruar, si më poshtë vijon:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: Lloji i dokumentit që e verteton sa me lart EKSTRAKTII THIESHTE DHE HISTORIK PER TE DHENAT E SUBJEKTIT. CERTIFIKATE RREGISTRIMI. Ieshuar nga autoriteti: [MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE, QENDRA KOMBETARE E BIZNESITI

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Lloji i dokumentit ge e verteton sa me lart eshtel Vertetim Ieshuar nga autoriteti, GJykata e Rrethit Tirane, si dhe vertetime të tiera te Ieshuara nga autoritetet Gjyqësore ne Republikën e Shqipërisë.

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

1. E. C – Administrator
2. B.C – Administrator
3. G. C - Drejtuese Teknike

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Deshmi Penalitetit Ieshuar nga autoriteti: [MINISTRIA E DREJTESISE. DREJTORIA E PERGJITHSHME E BURGJEVE

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme [VERTETIM NGA GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE VERTETIMI NGA GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE, MINISTRIA E DREJTESISE, DREJTORIA E PERGJITHSHME E BURGJEVE] Ieshuar nga autoriteti: [GJYKATA E RRETHIT TIRANE/GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE, MINISTRIA E DREJTESISE, DREJTORIA E PERGITHSHME E BURGJEVE]

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (EKSTRAKT HISTORIK PER TE DHENAT E SUBJEKTIT. VERTETIM STATUSI AKTIV/PASIVI Ieshuar nga autoriteti: [MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE, DENDRA KOMBETARE E BIZNESIT DREJTORIA E

PERGJITHSHME E TATIMENE DREJTORIA RAJONALE

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Lloji i dokumentit ge e verteton sa me lart: [Vërtetim per pagim detyrimesh, leshuar nga autoriteti: [MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE, DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE. DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE DTM.

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Lloji i dokumentit qe e verteton sa me lart. [Vertetim debie leshuar nga autoriteti: FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL (FSHU)

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Lloji i dokumentit ge e verteton sa me lart. [License per Tregetim me Shumice te Bamave.Leje Miedisore | leshuar nga autoriteti: [MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE, DENDRA KOMBETARE E BIZNESIT

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme VËRTETIM PER MOSPËRJASHTIM OE leshuar nga autoriteti: AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

III.2.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dërguar më shkresën nr. 1989/40 prot, datë 26.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 2003/3 prot, datë 29.07.2024, konstatohet se operatori ekonomik “DELTA PHARMA - AL” SHPK i kualifikuar i pari sipas parashikimeve të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në pikën 1/e “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT” të Shtojcën 7 “Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Shtojcën 8 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT”, i vulosur dhe i firmosur nga administratori i shoqërisë z. E. C.

- Vërtetim debie nr. OSHEE-2024-6551955-UG, datë 22.05.2024, i lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, OSHEE GROUP, ku vërtetohet se: “Bazuar në deklaratimet e deklaresit (përfaqësuesit ligjor) z. B. Ç, vërtetojmë se kërkuksi DELTA PHARMA-AL SHPK, nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën (me kod) TR3V160233579353, titullar i të cilës është DELTA PHARMA AL sh p k, rezulton të ketë në total 0 leke detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 22.05.2024, pa përfshirë faturen koherente të muajit Prill 2024.”.

III.2.6. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficiencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.2.7. Në nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

6. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, krijimi dhe plotësimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit kryhet në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

7. Pavarësisht parashikimeve të pikës 5 të këtij neni, operatorëve ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë nuk u kërkohet të paraqesin dokumente mbështetëse ose prova të tjera dokumentare për atë pjesë të informacionit të deklaruar dhe të gjeneruar automatikisht në Sistemin e Prokurimit Elektronik si pjesë e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga ndërveprimi me sisteme të tjera elektronike.

8. Operatorët ekonomikë mund të përmbushin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit edhe nëpërmjet dosjes virtuale të operatorit, e krijuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera elektronike për ruajtjen e dokumenteve. Dokumentet e dorëzuara si pjesë e dosjes virtuale të operatorit duhet të jenë të gjeneruara nga sisteme të tjera elektronike ose të noterizuara përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për përditësimin e të dhënave në mënyrë automatike, për aq sa është e mundur, në dosjen virtuale të operatorit.

9. Për operatorët ekonomikë vendës, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit për aq sa është e zbatueshme.

10. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor për operatorët ekonomikë të huaj i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në origjinal ose kopje të noterizuar dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike, të cilat nuk mund të gjenerohen automatikisht nga sistemet e tjera me anë të ndërveprimit. Dokumentet e noterizuara para noterëve publikë të Republikës së Shqipërisë dorëzohen online në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni sipas pikës 5 u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

11. Autoriteti ose enti kontraktor do të përdorë sistemin e-Certis për të marrë informacion për llojet dhe format e provave të përmendura në këtë nen dhe për autoritetet kompetente, që i lëshojnë ato në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.”.

III.2.8. Në nenin 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 7 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se:

“7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon, që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.”.

III.2.9. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

III.2.10. Në nenin 77, pika 1 dhe 5 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.2.11. Në nenin 11 (Leximi i Matësit dhe Faturimi i Energjisë Elektrike), paragrafi 11.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: “11.1 Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të Klientit, konform parashikimeve të Kodit të Matjes, Kodit të Rrjetit si dhe legjislacionit në fuqi për Metrologjinë, për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike dhe do ti dërgojë Klientit fundor në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit..”

III.2.12. Në nenin 13 (Pagesa dhe afati për kryerjen e saj), paragrafi 13.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: “13.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse.”

III.2.13. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.2.14. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.2.15. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik “DELTA PHARMA - AL” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin e ofertës në datën 03.06.2024 (data e zhvillimit të procedurës së prokurimit), ku në përmbushje të kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 1/e “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT” të Shtojcën 7 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT - të njëjta për të gjitha lotet”, ka dorëzuar në

dokumentacionin e ofertës edhe Shtojcën 8 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” ku në seksionin A: “*DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT*” duke deklaruar se: “*Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.*”

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Lloji i dokumentit që e verteton sa me lart. [Vertetim debie lëshuar nga autoriteti: FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL (FSHU)], ku në përfundim të vlerësimit të ofertave të paraqitura, komisioni i vlerësimit të ofertave në zbatim të parashikimeve të nenit 82 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*” të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, ka kualifikuar operatorin ekonomik ofertues.*

*Në vijim të hapave procedural të parashikuar në pikën 6 të nenit 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave më datë 25.06.2024, i ka dërguar njoftim operatorit ekonomik “*DELTA PHARMA - AL*” SHPK të kualifikuar, që të paraqesë dokumentacionin fizik që vërteton përmbushjen e deklarimeve të bëra në Shtojcën 8 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” të dorëzuar në dokumentacionin e ofertës.*

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit fizik të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “*DELTA PHARMA - AL*” SHPK, komisioni i vlerësimit të ofertave konstatoi se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 1/e “*KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT*” të Shtojcën 7 “*Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*” është dorëzuar vërtetim debie nr. OSHEE-2024-6551955-UG, datë 22.05.2024, i lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, OSHEE GROUP, ku vërtetohet se: “*Bazuar në deklaratimet e deklaresit (përfaqësuesit ligjor) z. B Ç, vërtetojmë se kërkuesi DELTA PHARMA-AL SHPK, nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën (me kod) TR3V160233579353, titullar i të cilës është DELTA PHARMA AL sh p k, rezulton të ketë në total 0 leke detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 22.05.2024, pa përfshirë faturat koherente të muajit Prill 2024.*”, ku pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni komisioni i vlerësimit të ofertave ka gjykuar se ky operator ekonomik nuk e ka plotësuar kriterin kualifikues të sipërpërmendur, pasi nisur nga data e zhvillimit të procedurës dhe konkretisht data 03.06.2024, ky operator ekonomik ka detyrime të maturuara të energjisë elektrike të palikujduara dhe konkretisht detyrimet e energjisë elektrike të muajit prill 2024, detyrime këto që janë maturuara në datën 01.06.2024.*

Nisur nga pretendimet e parashtruara nga ankimesi si në vijim: “Lidhur me arsyen e pretenduar nga KVO mbi vërtetimin e OSHEE sqarojmë se:”

Më datë 03-06-2024 në formularin e deklaratimit Formulari Përmbledhës 8 është deklaruar nga ana jonë se nuk kemi detyrime të maturuara deri më datë 03.06.2024 dhe nuk kemi paraqitur vërtetim, pasi vërtetimin e kemi dorëzuar fizikisht si pjesë e dosjes fizike.

Aplikimin për marrjen e vërtetimit e kemi bërë menjëherë, pasi janë publikuar dokumentet e tenderit objekt ankese dhe vërtetimi, i cili pas aplikimit vonon 5 ditë që të gjenerohet në e-albania ka dalë më datë 22.05.2024 ku akoma nuk ka qënë i maturuar Detyrimi i muajit Prill.

Detyrimi i muajit Prill është likuiduar më datë 31.05.2024 (pra para 03.06.2024) dhe vlera e detyrimit është vetëm 240 lekë, pasi Delta Pharma-Al ka instaluar panele diellore dhe energjinë elektrike e merr përmes tyre.

Ne disponojmë edhe Vërtetim të datës 01.07.2024, i cili vërteton që nuk ka detyrime të maturuara deri në Maj, por ky vërtetim nuk është dorëzuar si pjesë e dosjes fizike me qëllim mosparaqitjen e dokumentave të cilat mbajnë datën pas datës së hapjes së ofertave (bashkëlidhur kësaj ankese).”, Komisioni i Prokurimit Publik bëri verifikim pranë Furnizuesit të Shërbimit Universal FSHU si institucioni i cili menaxhon sistemin e të dhënave për pagimin e energjisë elektrike për të gjithë subjektet përdoruese të energjisë elektrike për të gjithë kontratat e lidhura midis Furnizuesit të Shërbimit Universal SHA dhe subjekteve përdoruese të energjisë elektrike, lidhur me detyrimet e maturuara të energjisë elektrike muajit prill 2024 të operatorit ekonomik “DELTA PHARMA-AL” SHPK, ku rezultoi se: “Pagesa e faturës së shitjes së energjisë elektrike e muajit Prill 2024 është kryer nga ana e subjektit më datë 31.05.2024”.

Nisur nga pretendimet e ankimuesi dhe arsyeja e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, Komisioni gjykon se deklaratimet e bëra nga operatori ekonomik “DELTA PHARMA-AL” SHPK janë të sakta, pasi më datë 03.06.2024 referuar përgjigjës nr. 3050/1 prot, datë 13.08.2024, protokolluar me tonën me nr. 2002/6 prot, datë 13.08.2024, të Furnizuesit Shërbimit Universal Sh.A (FSHU) në datën 31.05.2024 janë likuiduar detyrimet e energjisë elektrike të muajit prill 2024 dhe më datë 03.06.2024 (data e zhvillimit të procedurës së prokurimit) deklarimi i operatorit ekonomik ankimues lidhur me përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 1/e “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT” të Shtojcën 7 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” ka qënë i saktë.

Nisur nga fakti se qëllimi i ligjvënësit në përcaktimin e bërë në pikën 7/a të nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar është mos dhënia e kontratave publike operatorëve ekonomik të cilët nuk paguajnë detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, si dhe lidhur me përmbushjen e këtij kriteri kualifikues, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor në vlerësimin e dokumentacionit fizik të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik, sipas parashikimeve të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duhej që të bënte verifikime dhe duhej që ti kërkonte sqarime ofertuesit të kualifikuar lidhur me pagimin e detyrimeve të energjisë elektrike të muajit prill 2024, pasi nga verifikimet e kryera rezulton se në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi operatori ekonomik ankimues nuk ka patur detyrime të energjisë elektrike të maturuara të papaguara dhe për më tepër detyrimet energjisë elektrike të muajit prill 2024 i ka paguar përpara afatit të maturimit, pasi afati për tu paguar nga ky subjekt i faturës së muajit Prill 2024 është data 31.05.2024, sipas përcaktimeve në nenin 13 (Pagesa dhe afati për kryerjen e saj), paragrafi 13.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, ku ky afat është jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit, si dhe pagimi i detyrimeve të energjisë elektrike të muajit prill 2024 është bërë përpara datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

KPP gjykon se Furnizuesi i Shërbimit Universal është institucioni i ngarkuar me akt nënligjor për lëshimin e vërtetimit të debisë për personat fizikë dhe juridikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Në rastin konkret operatori ekonomik “DELTA PHARMA AL” SHPK rezulton se ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike për muajin prill 2024 përpara datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe përpara se këto detyrime të maturohen, pra nuk rezulton debitor për pagesën e energjisë elektrike të muajit prill 2024, duke përmbushur kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën/e “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të Shtojcën 7 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT - të njëjta për të gjitha lotet” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “DELTA PHARMA AL” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “DELTA PHARMA AL” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-03249-05-02-2024, me objekt: “B1 - Blerje barna sistemet Anestezi reanimacion, Anti tuberkulare, Antineoplastike dhe imunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna dermatologjike, Barna hormonale sistemike, Lëndë kontrasti për CT, Lëndë kontrasti për MRI, Lëndë kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës, Organet e shqisave, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular”, ndarë në 115 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)-ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj”, me fond limit 3,660,634,272 (tre miliard e gjashtëqind e gjashtëdhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH ose 36,493,214 Euro pa TVSH konvertuar ne euro sipas kursit zyrtar të Bankes së Shqipërisë date 02/05/2024, Loti 55 me Nr.REF-03376-05-02-2024, me objekt: “Lot55 Iodine x 370mg/ml” me fond limit 99,905,396.00 (nëntëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e pesë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH ose 995,966 (nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH konvertuar ne euro sipas kursit zyrtar të Bankes së Shqipërisë date 02/05/2024, zhvilluar në

datën 03.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*DELTA PHARMA AL*” ShPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri